



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo	
Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana - Ombudsperson Institution	
Nr./Br./No.	413/2021
Nr. i fq./Str./Nr.pg.	
Data/Datum/Date:	11/10/2021
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA I	

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267965
Datë: 07.10.2021
Numri i dokumentit: 02254581

A.nr.1373/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me zyrtarin ligjor, Fatlum Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson, Suzana Gashi, zyrtare e paditësit, kundër të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, të cilin e përfaqësojnë me autorizim, Ymer Fejzullahu, Ymredin Misini dhe Gani Buqaj, zyrtar të paditurit, për shkak të anulimit të vendimit dhe kompensimin e dëmit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarve të palëve më dt.15.09.2021 merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës në Prishtinë.

II. Anullohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, nr.V_399_2012 i dt.06.02.2012, dhe Detyrohet i padituri, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, që të ndërmarr veprime që e obligojnë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë Sh.A (KEDS) në Prishtinë, që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën kohore nga dt.06.02.2012, e deri më dt.20.10.2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40.855.480.00€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën pasojat e ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit, Suzana Gashi në seancën e shqyrtimit ka deklaruar, se Avokati i Popullit mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe precizimit të saj, duke kërkuar nga Gjykata anulimin e vendimit të të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, me nr. V_399_2012 të dt.06.02.2012 si të kundërligjshëm dhe të detyrohet i padituri që vepohet në bazë të ekspertizës ashtu që detyrohet i padituri që të ndërmerr veprime që e obligojnë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë Sh.A (KEDS) në Prishtinë që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40.855.480.00€) për energjinë e pa shpenzuar, por të ngarkuar qytetarëve të Republikës së Kosovës jashtë katër komunave veriore të Kosovës. Ka theksuar se ekspertiza financiare është e çarte dhe e kuptueshme prej secilin prej nesh dhe s'kemi vërejtje për këtë ekspertizë. Është shqyrtuar edhe parashtrësia e fundit që e ka dërguar ZRRE dhe të njëjtën e kundërshtojmë në tërësi, ngase nuk është kontestues fakti që edhe në bazë të ekspertizës, se rryma e shpenzuar në veri u është faturuar në mënyrë të kundërligjshme qytetarëve në pjesët tjera të Republikës së Kosovës, e këtë nuk e ka kontestuar as vet pala e paditur në seancë. Çfarë kishim dash të me shtuar është fakti se gjatë gjykimit nuk u trajtua diskriminimi, faturimi në mënyrë diskriminuese. Ne nuk e kontestojmë kompetencën e ZRRE sipas nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili i jep të drejtë ZRRE për caktimin e tarifave,

megjithatë duhet të kemi parasysh se ekziston edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 2 paragrafi 1, i cili mes tjerash thotë se ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mos veprimet e të gjitha institucioneve, dhe se përveç atyre që janë thënë në padi theksojmë se ky faturim është bërë në mënyrë diskriminuuese. I ka propozuar Gjykatës aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës në Prishtinë, të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, nr.V_399_2012 i dt.06.02.2012 dhe Detyrohet Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë që të ndërmarr veprime që e obligojnë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë Sh.a (KEDS) në Prishtinë, që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunitat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën kohore nga dt.06.02.2012, e deri më dt.20.10.2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40.855.480.00€).

I autorizuari i të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, Ymer Fejzullahu në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se ZRRE e kundërshton në tërësi atë çka tha e autorizuara e Avokatit të Popullit në këtë seancë, u potencua që vendimi i ZRRE është i paqarte për avokatin e popullit, apo edhe për palë të tjera të interesit dhe publikun. Bordi i ZRRE duke u bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, është i obliguar apo me saktësisht nenin 48 paragrafi 3 pika 3.3, që ndërmarrjet që i rregullon ti lejojë një nivel të arsyeshëm të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së distribucionit dhe transmetimit, dhe duke u bazuar në kompetencat e dhëna për Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, bordi i ZRRE e ka përgatitur një raport në të cilin janë përshkruar në detaje nivelin e arsyeshëm të humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes, gjithashtu në këtë proces me qenë sa më të paanshëm edhe për publikun dhe për të licencuarit Bordi i ZRRE ka angazhuar një kompani ndërkombëtare për vlerësimin e arsyeshëm të nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, e cila kërkohet sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. ZRRE apo bordi i ZRRE është i vetmi organ sipas ligjit që i jep të drejtën e nivelit të arsyeshëm të humbjeve në sistemin e shpërndarjes. Dhe në bazë të këtij raporti, dhe duke u bazuar në kompetencat e dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energji, Bordi i ZRRE duke u bazuar në këtë raport dhe duke u bazuar edhe në komentet e palëve të interesit, ku ZRRE-ja ka mundësuar të gjitha palëve që kanë shprehur interes lidhur me ekspertizën, ka nxjerr vendim për lakoren e reduktimit të humbjeve, e cila është bazuar në raportin konsultativ si dhe në raportin e kompanisë profesionale së bashku me komentet e palëve të interesit. Pra raporti konsultativ i ZRRE, i cili është i bazuar edhe në raportin e kompanisë konsulente, dhe në bazë të këtij raporti, duke u bazuar në nenin 48 paragrafi 3 pika 3.3, po e citoj gjatë miratimit Bordi i ZRRE, apo caktimit të tarifave rregullatori do të siguroj që të licencuarave, në atë kohë ka qenë KEK-u që në kohën e vendimmarrjes bartës i licencës ka qenë KEK, të ju mundësoj kthimin e të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë edhe kostot e nivelit të arsyeshëm të humbjeve të energjisë në Sistemin e Transmetimit dhe Shpërndarjes. Pra ky nen është zbatuar nga Bordi i ZRRE, duke u bazuar në raportin konsultativ, si dhe në komentet e palëve të interesit, duke përfshirë edhe komentet e IFC apo këshilltarit të transaksionit për privatizimin e distribucionit dhe shpërndarjes dhe Qeverinë, e cila është angazhuar nga Qeveria e Kosovës. Për me tepër sa i përket paqartësisë e cila u potencua nga avokati i popullit, ZRRE në të gjitha proceset e shqyrtimit i ka paraqitur edhe në vlerë energjetike edhe në vlerë financiare. Vlen të përmendet se edhe ekspertiza të cilën është përgatitur nga eksperti i angazhuar nga Gjykata shihet që është bazuar në vlerat, apo në të dhënat të cilat janë të publikuara dhe të marra nga raporti i ZRRE, i cili është publik dhe ju është dërguar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili është aprovuar në çdo vit, duke i përfshirë edhe humbjet të cilat ne po i diskutojmë. Sa i përket ekspertizës unë konsideroj, nuk do ta diskutoj vlerën meqenëse kjo është e bazuar në raportin e ZRRE, mirëpo ne konsiderojmë që ZRRE ka vepruar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili ka qenë në fuqi dhe konsiderojmë që kërkesëpadia për kompensimin e dëmit nga ana e ZRRE duhet të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

I autorizuari i dytë i të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, Ymiridin Misini në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ZRRE e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, dhe i mohon të gjitha faktet e cekura të paditësit në tërësi. Sipas vendimit V_399_2012 të dt.06.02.2012, kemi të bëjmë me katër parametra rregullativ ku përfshihet mesatarja e ponderuar, e cila ka qenë 15% nominale përfshirë 3% për periudhën tranzitore deri në shqyrtimin e ardhshëm periodik 1+5 meter, me supozimin se liverazhi është 50%, lakorja e humbjeve në shpërndarje nga vlera e realizuar në vitin 2011

dhe e reduktuar për 3% në 3 vitet e para, dhe në 2.5% në vitet pasuese. Niveli i borgjit të keq 5% për 3 vitet e para, dhe 4% për vitet pasuese, fatura e efqencës është 0 për 3 vitet e para, dhe me shumë se 5% për vit për 3 vitet pasuese. Parametrat e përmendur në këtë vendim janë përcaktuar gjatë shqyrtimeve periodike në përputhje me rregullat për përcaktimin e tarifave dhe të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të të gjithë të licencuarve, gjenerimin, transmisionin, distribucionin dhe furnizimin. Qëllimi i këtij vendimi ka qenë reflektimi i vlerave të përafërta që konsiderohen të arsyeshme për të hyrat maksimale. Vlen të theksohet se vendimi i atakuar nga ana e paditësit është i bazuar në dokumente ligjore materiale përfshirë caqet indikativë të humbjeve në rrjetin e distribucionit përfshirë përcaktimin e vlerës indikativë të mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit, të cilat dokumente në konsultim edhe me publikun janë miratuar në mbledhjen e mbajtur me 29 nëntor 2011. Duhet theksohet se qëllimi kryesor i vendimit për përcaktimin e vlerave indikativë ka qenë reflektimi i vlerave të përafërta që janë konsideruar të arsyeshme për llogaritjen e hyrave maksimale të lejuara në pajtim me konkluzionet dhe komentet e pranuar nga palët e interesit në nenin 48 paragrafi 3 pika 3.3 ku thuhet se “ZRRE gjatë miratimit apo caktimit të tarifave do të siguroj që të licencuarave ti mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë përveç tjerash edhe kostot e niveleve tjera të humbjeve tjera të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes. Meqenëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka pasur të pamundur qasjen në veri të vendit, humbjet që shkaktohen në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë konsideruar si humbje politike dhe si të tilla janë konsideruar si humbje jashtë kontrollit të Operatorit të Shpërndarjes. Me këto humbje OSSH nuk mund të kryej funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë e cila e rrezikonte mos furnizim me energji të konsumatorëve të Republikës së Kosovës. ZRRE edhe në rastin e pretendimit sipas padisë për pasurim të pabazë se trajtimi i borgjit të keq që buron nga 4 komunat veriore krijon një pasurim të pabazë, ka konsideruar dhe vlerësuar se pretendimi ka qenë i pabazë, pasi që shumica e borgjit të keq që rrjedh nga furnizimi i energjisë elektrike duke ju referuar vlerës me energji të shumëzuar me energjinë e marruar në transmisionin-varash si dëshmi nga të dhënat e pagesës së furnizuesit. Meqenëse kjo llogaritje rikompenson furnizuesin vetëm për shpenzimet e ligjshme të shkaktuara ZRRE në kuptim të Ligjit të Marrëdhënieve të detyrimeve nuk e konsideron si pasurim i pabazë i furnizuesit. Çdo përpjeke për të imponuar koston e mbajtjes së furnizimit të energjisë elektrike përben një shkellje të neneve 46 dhe 119 në veçanti paragrafet 1, 2, 4, 6, të Kushtetutes së Republikës së Kosovës dhe dispozitës materiale të neni 48 të Ligjit për Rregullator të Energjisë, duke kërkuar nga furnizuesi që të pësojë një kosto dhe duke mos lejuar atë që të kompensoj atë që duhet për dallim nga trajtimi që i është dhënë paraardhësit të tij shtetëror KEK. Sa i përket pikës dy të paditësit për kompensim dëmi si dhe për plotësim të padisë me të cilën është kërkuar që të obligohet ZRRE të ndërmarr veprime që obligojnë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë që të bëjë kthimin e shumës së faturuar respektivisht të konsumatorëve për shpenzimet e energjisë elektrike të 4 komunave veriore të Republikës së Kosovës konsiderojmë se kërkesa e tillë është e papranueshme dhe si e tillë duhet të hedhet si e palejueshme, pasi që ZRRE vepron vetëm si organ administrativ i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe detyrat e saj janë të përcaktuara me Ligjin për Energji. Përveç detyrave tjera të caktuara me ligj ka për obligim vetëm të caktimit të tarifave në aspektin rregullativ të sektorit të energjisë, pra administrativ, ku ju caktohet buxheti i të licencuarve që veprojnë brenda vitit rregullativ, dhe për shërbimet dhe ngarkesat e tilla që operojnë të licencuarit për distribuim dhe energji elektrike, mblidhen nga tarifat me pakicë nga konsumatorët e energjisë në Republikën e Kosovës. Po ashtu konsiderojmë që Gjykata e shkallës së parë në rastin e marrjes së aktgjykimit do të vërtetoj drejtë gjendjen faktike, pasi që vendimi i atakuar nga paditësi nuk ka të bëjë me çështjen që pretendohet, pasi që kemi të bëjmë vetëm me përcaktim të parametrave si në dispozitiv të vendimit V_399_2012, e të cilën e kemi trajtuar edhe përmes përgjigjes në padi. I cili vendim ka përfshirë periudhën 3 vjeçare të rregullimit, e jo ndonjë vendim me të cilën pretendon paditësi. Nga krejt kjo që e theksuam konsiderojmë se Bordi i ZRRE-së kur ka vendosur për nxjerrjen e vendimit të atakuar për parametra rregullativ, vendimi i tij është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligji nr.03/L-085, viti 2010, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, neni 14 nënparagrafi 2.7, neni 25, 40 të cilët janë të harmonizuara me Ligjin nr.05/L-085 gjegjësisht neni 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, neni 25 paragrafi 8, neni 26 paragrafi 1 dhe 5, neni 47 paragrafi 3.5, neni 48 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.8, neni 49 dispozitat e neni 3 nënparagrafi 3, neni 18 nënparagrafi 1, neni 28 paragrafi 1 neni 38 nënparagrafi 4.1 të Ligjit të Energjisë Elektrike, në pajtim me direktivën e Bashkimit Evropian nr.2009/72, e cila është transpozuar në legjislacionin e sektorit të

energjisë në Kosovë si dhe dispozitat e rregullave dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga organi i bordit të ZRRE-së të cilat janë në fuqi.

Gjykata në këtë çështje i ka dhënë mundësi edhe KEDS-it që të marrë pjesë në këtë procedurë, duke e cilësuar si palë me interes juridik në këtë çështje, mirëpo i njëjti edhe pas pranimit të thirrjes për seancën e dt.28.07.2021, duke i dërguar padinë, përgjigjen në padi e të paditurit dhe ekspertizën financiare të dt.31.05.2021, por i njëjti nuk i është përgjigjur Gjykatës në asnjë mënyrë.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.15.09.2021 ka bërë administrimin e provave dhe atë; vendimi i të paditurit me nr.V_399_2012 i dt.06.02.2012, kërkesa e paditësit drejtuar ZRRE-Krenar Bujupi e dt.04./05/2017, përgjigja e lëshuar nga ZRRE për paditësin e dt.18.05.2017, raport i rekomandimit e lëshuar nga institucioni i Avokatit të Popullit me nr.265/2017 i dt.13.06.2017, informata e lëshuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut Sha KOST nga Prishtina për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, ZRRE dhe KEK e dt.27.10.2009, kërkesa e KEK-ut drejtuar Drejtorit të Policisë së Kosovës, Shefit të Misionit të EULEX-it dhe komandantit të KFOR-it e dt.04.03.2010, rekomandimi i Kuvendit të Kosovës i dt.15.02.2018, ekspertiza financiare e përgatitur nga eksperti financiar, Riza Blakaj e dt.31.05.2021, precizimi i padisë se paditësit i dt.13.08.2021, parashtrësja e ZRRE-së e dt.29.07.2021, me provat e bashkangjitura dhe atë; caqet indikativë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, përcaktimi e parametrave kyq rregullator dhe shkresën zyrtare të IFC të pranuar përmes postes elektronike me dt.24.01.2012 nga kryesuesi i ZRRE-së, si dhe provat e bashkangjitura përgjigjes në padi të dt.09.11.2018 dhe atë nga numri I deri në numrin 15.

Gjykata vlerësoi kërkesëpadinë e paditësit në përputhje me nenin 43, 44 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurit nën shenjë V_399_2012 të dt.06.02.2012, është vendosur, I. Mesatarja e ponderuar, e kostos së kapitalit 15% nominale (përfshirë inflacionin prej 3%) për periudhën tranzitore dhe për shqyrtimin e ardhshëm periodik (1+5 vjet) me supozim se leverazhi (gearing-u) është 50%. II. Lakorja e reduktimit të humbjeve në shpërndarje do të fillojë nga vlera e realizuar në vitin 2012 dhe do të reduktohet në 3% (pike përqindje) në 3 vitet e para dhe 2.5% (pike përqindje) në 3 vitet pasuese. Faktori i ndarjes së humbjes do të jetë 0%. III. Niveli i borxhit të keq do të jetë 5% për 3 vitet e para dhe 4% për 3 vitet pasuese. IV Faktori i efciences do të jetë 0% për 3 vitet e para dhe me se shumti 5% në vit, për 3 vitet pasuese. ZRRE sygjeron që të konsultohet publiku para vendosjes definitive të caktimit për 3 vitet pasuese.

Nga vendimi i kontestuar Gjykata gjen se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 paragrafi 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton aktin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Akti i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e tij. Në arsyetimin e aktit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se "Pas konsultimit me publikun, ne mbledhjen e mbajtur me 29 dhjetor 2011 Bordi i ZRRE-së ka miratuar vlerat indikative

për reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe vlerën indikative të mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Qëllimi i atij vendimi ka qenë reflektimi i vlerave të përafërta që janë konsideruar të arsyeshme për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara, në pajtim me konkluzionet dhe komentet e pranuar nga palët e interesit. Me datë 24 janar 2012 ZRRE ka pranuar një shkresë nga Këshilltarët e Qeverisë për Transakcionin e KEDS-it lidhur me vlerat indikative të ZRRE-së. Në shkresën e tyre e cila sipas këshilltarëve të transakcionit, është hartuar me kërkesën e Ministrit për Zhvillim Ekonomik, ata theksojnë se vlerat indikative të përcaktuara nga Rregullatori nuk janë të mjaftueshme për të siguruar investime në KEDS, në pajtim me Strategjinë e Energjisë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës”.

Nga arsyetimi i vendimit të kontestuar, Gjykata vëren se i padituri vetëm ka bërë citimin e vendimit të Bordit të ZRRE-së të datës 29 dhjetor të vitit 2011 dhe shkresën e këshilltarëve të Qeverisë për Transakcionin e KEDS-it të datës 24 janar 2012, duke konstatuar se “Bordi i ZRRE-së i ka shqyrtuar dhe pjesërisht i ka marrë në konsiderat kërkesat e Këshilltarëve të Transakcionit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi”, duke mos arsyetuar kështu asnjë nga katër pikat e dispozitivit të vendimit të kontestuar me padi, në këtë kuptim Gjykata vlerëson se vendimit të kontestuar i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 84 të Ligjit për Procedurën Administrative, kjo për faktin se vendimi, përkatësisht arsyetimi i vendimit duhet të siguroj palëve mundësinë që ta kuptoj aktin administrativ, të këtë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve dhe në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Ndërsa mungesa e një arsyetimi që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtë në apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Paditësi i duke u bazuar në nenin 16.4 të Ligjit për Avokatin e Popullit me 7 prill 2017 ka inicuar hetime me iniciativën e vet (ex officio) duke u bazuar në shkrimin e gazetës “Zëri”, të datës 07 prill 2017, me titull “KEDS-i na faturon 8 milion euro në vit për rrymën e serbeve të veriut”. Ndërsa pas hetimeve të kryera dhe përgjigjeve të marra nga i padituri më dt.15.08.2017, ushtron padi në këtë Gjykatë duke kontestuar vendimin e të paditurit të dt.06.02.2012.

Avokati i Popullit në bazë të hetimeve administrative të zhvilluara në kuadër të përgjegjësisë së tij ligjore, për të mësuar për ligjshmëritë e këtyre veprimeve ka ardhur në përfundim me gjetjen e tij të paraqitura në Raportin me Rekomandime, të datës 13 Qershor 2017, drejtuar të paditurit, ku kishte rekomanduar ZRRE-në që 1.ZRRE urgjentisht të ndal praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës tek konsumatorët në pjesën tjetër të vendit; 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in të gjejë një mënyrë alternative për t’iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe Ligjit Kundër Diskriminimit; 3. ZRRE-ja në pajtim me Ligjin për Rregullatorin për Energji, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilët, padrejtësisht janë faturuar, dhe vazhdojnë të faturohen, për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.

Me datën 12 Korrik 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ZRRE me të cilën ZRRE-ja kundërshton shumicën e gjetjeve të Avokatit të Popullit.

Gjykata vëren se i padituri me vendimin e kontestuar me padi nga i padituri ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 55 ku përcaktohet se “1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj. 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar. 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së

qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës praktika faturimit nuk është në përputhje me Ligjin për Rregullatorin për Energjinë Elektrike. Ngase është bërë trajtim jo i barabartë i banorëve të katër komunave veriore të Kosovës në raport me banorët në pjesën tjetër të Republikës së Kosovës, dhe se njëjti faturim nuk është i autorizuar me ligj dhe mbi këtë bazë është masë jo proporcionale sipas nenit 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas paragrafit 4 të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar se “Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël”. Në këtë rast, kjo dispozitë kërkon që ZRRE-ja, si dhe të gjitha institucionet kompetente për rregullimin ligjor të fushës së energjisë elektrike, të shqyrtoje nëse qëllimi i pretenduar i praktikës aktuale të faturimit, qëllimi i mosrrezikimit të sistemit të energjisë elektrike në mbarë territorin e Republikës së Kosovës mund të arrihet me një trajtim të barabartë ndërmjet të gjithë banorëve të vendit.

Ndërsa me vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen (Burden v. United Kingdom, Aplikimi Nr.13378/05, GJEDNJ, i dt.29 prill 2008), ti cilit vendim duhet ti referohemi sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konceptit të “pronës” dhe të “posedimit” u është dhënë një kuptim i gjerë, duke përfshirë çdo lloj pronësie të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe një sërë interesash ekonomike. Në veçanti GJEDNJ ka konstatuar se “Tatimi është, parimisht, një kufizim i së drejtës së garantuar në paragrafin e parë të nenit 1 të Protokollit të Parë (të KEDNJ-së), për shkak se tatimi e privon personin në fjalë nga një posedim-e drejtë”, “nga sasia e parave që duhet paguar”. Sipas këtij arsyetimi, çdo herë që shteti e detyron një individë për të paguar një sasi parash, kjo konsiderohet një kufizim i së drejtës së pronës.

Me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit Nr.04/L-121, neni 4 garantohen të drejtat themelore të konsumatorit siç janë e drejta për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit si dhe e drejta për të mbrojtur pronën. Ndërsa me nenin 12 është përcaktuar se “1. Faturimi i energjisë dhe i ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit. 2. Mënyra e matjes dhe e llogaritjes të energjisë dhe ujit rregullohet me ligje dhe akte tjera nënligjore. 3. Furnizuesi detyrohet që konsumatorit t’ia mundësojë paraprakisht njoftimin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë dhe ujit. 4. Furnizuesi duhet të paraqesë në faturë shënime që i mundësojnë konsumatorit kontrollin e sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë dhe ujit. 5. Furnizuesi është i detyruar t’u përmbahet standardeve të shkruara të cilësisë dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve të energjisë dhe ujit. 6. Faturimi i energjisë dhe ujit duhet të llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet njësoreve të kalibruar. 7. Furnizuesi i shërbimeve të telekomunikimit duhet që për kryerjen e shërbimeve t’ia dorëzojë faturën konsumatorit, e cila përmban shënime të nevojshme për llogarinë e shumës së përgjithshme që e detyron konsumatorin të paguaj vlerën, taksën si dhe shumën e përgjithshme të llogaritur në Euro”. E nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vëren se nuk është bërë faturim real i energjisë se shpenzuar nga qytetarët jashtë katër komunave veriore të Kosovës siç është përcaktuar nga ky ligj, përkatësisht janë ngarkuar për të paguar për energjinë të cilën në fakt nuk e kanë shpenzuar.

Me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr.05/L-021, përkatësisht neni 2 të te njëjtit, është përcaktuar se “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës.” kurse neni 3.1 dhe 2 të te njëjtit, përcakton se “1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. 2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose

preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çenoi njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”. Ndërsa neni 4 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj përcakton se “Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim:1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. 2.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme”. Pra Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara me nenin një të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çenoi njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës, Njësoj si vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së, ligji thekson se një trajtim jo i barabartë mund të justifikohet nëse ka “Një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar”. E në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk ka pasur qëllim legjitim dhe proporcional ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar nga i padituri, kur duke u bazuar në vendimin e tij KEDS i ka detyruar qytetaret jashtë katër komunave veriore të Kosovës të paguajnë për energjinë e shpenzuar në veri.

Me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, neni 194 është përcaktuar se “1. Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur. 2. Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve. 3. Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”. Në baze të këtyre dispozitave, konsumatorëve të cilët pa dijen e tyre kanë paguar për energjinë e shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës, u lind e drejta për kthimin e shumës që janë detyruar ta paguanin. E në këtë rast Shërbimi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë Sh. A (KEDS) në Prishtinë është pasuruar pa bazë ligjore, kur është bazuar në vendimin e të paditurit dhe i ka faturuar konsumatorët jashtë katër komunave veriore të Kosovës për energjinë elektrike të pa konsumuar.

Me rekomandimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.97/2018 të dt.15.02.2018, gjykata vëren se Kuvendi në mbledhjen e datës 8 dhe 9 shkurt 2018, pasi ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Kosovës, ka rekomanduar: 1. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) urgjentisht të ndal praktikat e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës, të konsumatorët në pjesën tjetër të vendit. 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjej një mënyrë alternative për t’iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë, sipas normave kushtetuese dhe ligjeve kundër diskriminimit. 3. ZRRE-ja, në pajtim me ligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilët do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve, të cilët, padrejtësisht, janë faturuar dhe vazhdojnë të faturohen për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore”.

Ndërsa me vendimin e të paditurit V_1019_2018 të datës 20 gusht 2018, me të cilin është aprovuar caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë 2018-2022 për rrjetin e transmetimit (OST) dhe rrjetin e shpërndarjes (OSSH) që do të filloj nga niveli i realizuar i humbjeve në vitin 2017. Ku në pikën IV të të njëjtit vendim është përcaktuar se “Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara nuk aplikohet për sasinë e energjisë së pa faturuar në katër (4) komunat e veriut të Republikës së Kosovës. Pra me këtë vendim i padituri cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara ka vendosur të aplikohet vetëm në pjesën e Republikës së Kosovës në të cilën të licencuarit kanë kontroll, kurse me vendimin e kontestuar me padi, një përjashtim

i tillë nuk ka ndodhur, fakt ky që e provon pretendimin e paditësit se vendimi i të paditurit mbi bazën e të cilit pastaj janë faturuar konsumatorët jashtë katër komunave veriore të Kosovës për energjinë e shpenzuar, dhe të pa paguar në katër komunat e veriut të Kosovës është i kundërligjshëm.

Për të përcaktuar saktë lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit, Gjykata me propozim të autorizuarës së paditësit, ka nxjerrë provë me ekspertizë financiare, të cilën e ka përgatitur me shkrim eksperti financiar, Riza Blakaj me dt.31.05.2021, të cilës Gjykata ia fali besimin, i cili ka nxjerr përfundim se “Dëmi i shkaktuar konsumatorëve të pjesës tjetër të Kosovës, si rrjedhojë e energjisë elektrike, të pa faturuar, konsumatorëve të pjesës së katër komunave të veriut të Kosovës, dhe atë: Mitrovica e veriut, Laposaviqi, Zveqani dhe Zubin Potoku, përgjatë periudhës kohore prej: 06.02.2012-20.10.2017, është në shumë: 40.855.480€, përkatësisht sipas viteve: periudha 06.02.2012-31.12.2012: 5.911.790.00€, viti 2013: 6.590.000.00€, viti 2014: 6.206.000.00€, viti 2015: 6.953.000.00€, viti 2016: 8.595.000.00€, periudha 01.01.2017-20.10.2017: 6599.690.00€, gjithsej: 40.855.480€. Të njëjtën ekspertizë nuk e kanë kundërshtuar të autorizuarit e të paditurit, me arsyetim se njëjta ekspertizë është përgatitur duke u bazuar në të dhënat e tyre e të cilat janë publike, por e kanë kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarve të paditurit, se padia e paditësit është e pasafatshme, për faktin se padia nuk është parashtruar në Gjykatë brenda afatit prej 30 ditësh, Gjykata të njëjtin pretendim e vlerëson si të pa bazuar për faktin se në këtë rast përjashtohet afati 30 ditor i përcaktuar me ligj për parashtrimin e padisë, ngase praktika e GJEDNJ-së, por edhe të praktika e gjykatave vendore ka konstatuar se “Kur është e çarte se kërkuesi nuk disponon asnjë ankim efektiv, afati gjashtëmuor fillon me datën e akteve ose datave të denoncuar ose me datën në të cilën i interesuari njihet me to, ose ua ndjen pasojën apo dëmin, rasti (Dennis dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, dhe rasti: Varnava e të tjerët kundër Turqisë (DHM) 157)”. Gjykata vëren se Avokati i Popullit është vë në dijeni për faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në veri më anë të shkrimit në gazetën “Zëri” të datës 7 Prill 2017, me titull “KEDS-i na faturon 8 milion euro në vit për rrymën e serbeve të veriut”, dhe paditësi pasi ka marrë informatë-përgjigje nga i padituri brenda afatit ligjor ka ushtruar padi në Gjykatë dhe në këtë kuptim nuk mund të themi se kaluar afati absolut për parashtrimin e padisë. Po ashtu sipas praktikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me aktvendimin Rev.nr.196/2015, ka gjetur se “Propozuesi nuk ka mundur të ushtrorë të drejtën e tij për gjykim të drejtë pa ju dhënë mundësia ti dorëzohet personalisht vendimi përfundimtar me caktimin e kompensimit për pasurin e tij të shpronësuar”. Gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e njeh dhe e praktikon konceptin e “Situatës në vazhdim”, në rastet kur ankesa paraqitet pas afatit katër muor, i cili përcaktohet me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, kur kemi të bëjmë me një shkelje të vazhdueshme. Në rastin K1-13/17, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se “Kriteri për parashtrimin e kërkesës brenda afatit prej 4 muajve nuk zbatohet në rastet e shkeljes së pretenduar të vazhdueshme të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, Rasti K150/12 parashtrues i kërkesës, Agush Lolluni, (aktgjykim i dt. 20 korrik 2012). Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi i të paditurit është një vendim i përgjithshëm, me efekt financiar të secili qytetar i Republikës së Kosovës, përjashtuar këtu qytetarët e katër komunave të veriut të Kosovës, kundër të cilit sipas këshillës juridike të vendimit, palët e pakënaqura kanë pasur të drejtë të ngritin konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE. Gjykata vëren se koha e shpalljes së vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së është e vërtetuar, por nuk është provuar nga i padituri se i ka dorëzuar këtë vendim ndonjëherë nga palët që do të mund të jenë të goditura nga ky vendim, apo të ketë njoftuar palët për efektet e këtij vendimi, dhe në këtë kuptim padia e paditësit është e ushtruar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër të të paditurit, të dhëna në përgjigje në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, por të njëjtat pretendime i vlerëson si të pabazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është provuar se i padituri ka vendosur në kundërshtim me 55.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kundërshtim me nenin 194 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, në kundërshtim me nenin 4 dhe 12 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit Nr.04/L-121, në kundërshtim me nenin 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskrimini Nr.05/L-021, në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për

Numri i lëndës: 2019:267965
Datë: 07.10.2021
Numri i dokumentit: 02254581

Rregullatorin e Energjisë, NR.05/L-084, si dhe në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nr.05/L-085.

Mbi këto arsye Gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës në Prishtinë, duke e anuluar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, nr.V_399_2012 të dt.06.02.2012, dhe e ka detyruar të paditurin, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, që të ndërmarr veprime që e obligojnë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë Sh. A (KEDS) në Prishtinë, që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën kohore nga dt.06.02.2012, e deri më dt.20.10.2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40.855.480.00€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën pasojat e ekzekutimit me detyrim.

Duke u bazuar në të arsyet e dhëna më lartë, dhe në pajtim me nenet 5, 6, 38, 43, 44, dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1373/2017, dt.15.09.2021

Zyrtar Ligjor
Fatlum Gashi



Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.